Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0300

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) përmes Panelit Shqyrtues në përbërjen individuale të Vjosa Gradinaj Mexhuani, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik (OE) "Ortho - Implants" ShPK. e datës 24.05.2023, ushtruar për shkak të refuzimit të qasjes në dokumentet publike, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Sharrë Borer Ortopedik" regjistruar me numër të prokurimit 70030-23-2663-1-2-1, iniciuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë nga cilësia e Autoritetit Kontraktues (AK), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP), me 13.07.2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet si e bazuar, ankesa e OE "Ortho - Implants" ShPK. e datës 24.05.2023 (Protokolli: Nr. 300/23) por mbetet në fuqi Vendimi i AK, i datës 11.05.2023 për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Sharrë Borer Ortopedik" regjistruar me numër të prokurimit 70030-23-2663-1-2-1, për shkak të interesit të përgjithshëm.

2. Iniciohet sipas detyrës zyrtare, procedura për marrjen e licencës së prokurimit ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit, në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë, për shkak të shkeljes së nenit 108A lidhur me nenin 112 paragrafit 1 të LPP.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore, kështu që ankuesi ka të drejtë të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës, brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, konfiskohet tarifa ankimore, kurse mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës, sikurse parashihet kjo me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.03.2023, Spitali i Përgjithshëm në Pejë, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Sharrë Borer Ortopedik" i regjistruar me numër të prokurimit 70030-23-2663-1-2-1. Aktiviteti i prokurimit në rastin konkret, është zhvilluar sipas procedurës së hapur, me llojin e kontratëspër furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 45,000.00 €, përderisa kriteri i dhënies (eventuale të kontratës) ka qenë tenderi i përgjegjshëm, me çmimin më të lirë.

Me 11.05.2023 AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e tij/sajë, përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë OE "Agani Ltd" ShPK.

Me 16.05.2023, OE "Ortho - Implants" ShPK, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 22.05.2023.

Me 24.05.2023, i pakënaqur me vendimin e cituar si më sipër të AK, OE "Ortho - Implants" ShPK, ka parashtruar ankesë në OSHP ankesën (e cila është regjistruar me numër protokolli 300/23).

Në prezantimin e fakteve dhe rrethanave të përshkruara si më sipër, duhet theksuar domosdo se, *Autoriteti Kontraktues nuk e ka pezulluar zbatimin e aktivitetit të prokurimit në përputhje me nenin 112 par. 1 të LPP pasi që gjatë kohës sa ka qenë duke u shqyrtuar ankesa konkretisht me datë 06.06.2023 ka publikuar B08 Njoftimin për dhënie të kontratës.*

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës,

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtroj ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105 të LPP.

Duke ju referuar nenit 111 paragrafi 5, lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore. Lidhur me ketë, ka pranuar Raportin e Ekspertit Shqyrtues me 26.05.2023 OSHP, i cili përmban me rekomandimet si në vijim:

Ankesa të aprovohet si e bazuar;

Të anulohet Vendimi për dhënie të kontratës, dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim;

Raporti i ekspertizës është pranuar në mënyrë të rregull nga palët procedurale, me ç 'rast AK nuk është deklaruar fare, ndërsa ankuesi është pajtuar me rekomandimin e ekspertit. Duke ju referuar veprimeve të ndërmarra si më sipër, Paneli Shqyrtues konsideron se janë plotësuar kushtet për të vendosur në mënyrë meritore mbi këtë çështje, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, duke pasur parasysh faktin se aktet dhe veprimet dhe parashtresat e palëve, provat në dispozicion dhe raporti i ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me çështjen.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Ankuesi ka pohuar se me 11.05.2023, pas pranimit të njoftimit mbi vendimin e AK, ka parashtruar kërkesë për qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe OE të tjerë ofertues, mirëpo AK nuk ka kthyer përgjigje fare, duke pohuar po ashtu se, përsëri me 15.05.2023 i është drejtuar AK dhe me një kërkesë tjetër, po ashtu për qasje në dokumente duke i kujtuar AK se me 16.05.2023 është dita e fundit për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim dhe konform nenit 10.3 të LPP.Më tej, ankuesi ka pohuar se në vendimin e datës 22.05.2023, me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, AK ka cekur që nuk ka dëshmi se, tani Ankuesi, ka parashtruar kërkesë për qasje në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë. Në rrethana të tilla, ankuesi konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 10.3 dhe 10.5 të LPP.

Lidhur me pohimet e ankuesit, të përshkruara shkurtimisht si më sipër, në raportin e ekspertit shqyrtues shpjegohet se parashtruesi i ankesës në kërkesën për Ri-shqyrtim dhe ankesën e dorëzuar në OSHP, fillimisht e ka kundërshtuar heshtjen e AK dhe mos-dhënien e qasjes në dokumente publike, me ç rast konsideron se i është pamundësuar ankese të mirëfilltë.Në raportin e ekspertit shqyrtues, konstatohet se (bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive platformën e-prokurimi) ankuesi ka kërkuar qasje në dokumente tri herë dhe atë: me datë 11.05.2023; me datë 15.05.2023 dhe me datë 15.05.2023. Kurse, AK nuk ka dhe përgjigjenë asnjërën nga kërkesat e dorëzuara nga ankuesi. Ndërsa në vendimin e tij/sajë mbi refuzimin kërkesës për ri-shqyrtim, AK

potencon faktin se, cituar: "...nuk kemi informata -dëshmi qe keni parashtruar kërkesë për qasje në ofertën e operatorit të rekomanduar". Në ketë rast, në raportin e ekspertit shqyrtues shprehimisht theksohet se, arsyet e dhënë nga AK nuk qëndron për faktin se tek butoni "Dokumentet-Letrat Standarde" janë të paraqitura të gjitha kërkesat e lartë cekura". Andaj, sipas opinionit të ekspertit shqyrtues, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 paragrafët 3 dhe 5 të LPP, sepse në kuptim më dispozitës së cituar autoriteti kontraktues ka për detyrë ti siguroj qasje të arsyeshme palës e cila e kërkon ketë lidhur me të dhënat e parapara me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyll ur, duke e shpjeguar në vijim faktin se në cilat raste, një aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur, në kuptim të LPP. Duke ju referuar provave në dispozicion të shkresave të kësaj lënde dhe analizimit të tyre, në raportin e ekspertit shqyrtues thuhet mes tjerash se, AK ka vepruar në kundërshtim dhe me nenin 7 paragrafët 7.2 dhe 7.4, të Rregullores për prokurim publik, sipas së cilës, cituar: "Qasja në të dhënat e aktivitetit të prokurimit fillon në datën e pranimit nga OE të njoftimit mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit – publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK " dhe se, cituar: "AK do ti ofroj, çdo pale të interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit...". Në raportin e Ekspertit Shqyrtues shpjegohet më tej se, ankuesi ka argumentuar pohimet ankimore, dhe se Është përgjegjësi e Autoritetit kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së dhe t'i trajtoj në mënyrë të barbarët të gjithë OE duke ju lejuar qasje në dokumente publike sipas nenit 10 paragrafi 3, analizoj çmimin e secilit operator ekonomik në këtë aktivitet te prokurimit, në mënyrë që të respektohen, kriteri i dhënies së kontratës, kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 në dosje te tenderit. Andaj , vlerësojmë se pretendimet e palës në ankesë janë të qëndrueshme"

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se AK ka shkulur dispozitat e cituara si më sipër, të precizuara dhe të argumentuara ato në ankesë dhe në raportin e ekspertit shqyrtues. Në ketë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesional dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dh e114 të LPP. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht

dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel. Nga kjo pikëpamje, Paneli konsideron se secili AK, duhet të respektoj me përpikëri nenin 8 (planifikimi i prokurimit) lidhur me nenin 9 (Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur), lidhur me nenin 27 (dosja e tenderit) nenin 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve), duke mos e mohuar në asnjë rast të drejtën e garantuar të OE, për qasje në dokumente. Prandaj pretendimet ankimore dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, sipas këtij Paneli, gjejnë mbështetje në legjislacionin primat dhe sekondar për prokurimin publik, andaj pohimet ankimore konsiderohen tërësisht të bazuara.

Megjithatë Paneli Shqyrtues nuk vendosi për ta kthyer në ri-vlerësim aktivitetin e prokurimit, kryesisht për faktin se nisur nga parimet bazë të LPP përfshire nenin 1,6, lidhur me nenin 104 paragrafi 4 i LPP, konsideron se në këtë aktivitet të prokurimit kemi të bëjmë me furnizimin me pajisje mjekësore dhe furnizimi me artikuj tillë duhet të trajtohet me kujdes të shtuar për shkak të interesit të publikut. Dhe përveç tjerash, rishqyrtimi i aktivitetit të prokurimit nuk përfshihet në pretendimet ankimore. Prandaj Paneli Shqyrtues, vendosi që ky aktivitet i prokurimit të vazhdoj për shkaqet dhe arsyet e shpjeguara si më sipër, mirëpo AK mban përgjegjësinë e plotë për shkeljet e argumentuara në mënyrë specifike në raport me dispozitat e cituara në ankesë dhe në ekspertizë. Paneli me pavarësinë e plotë profesionale, në mënyrë të pavarur dhe objektive, ka vlerësuar me kujdes të gjitha faktet dhe provat në dispozicion dhe konstaton se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 par. 3 dhe 5 të LPP lidhur me nenin 7 par. 2 dhe 4 të RRPP. Aq me tepër, në nenin 112 paragrafi 1 të LPP parashihet se, cituar: "Përveç nëse paneli përkatës shqyrtues nxjerr një vendim tjetër me shkrim dhe përderisa ta nxjerrë këtë vendim, dorëzimi i një ankese e obligon autoritetin kontraktues që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë ankesa në fjalë". Në rastin konkret, AK respektivisht zyrtari përgjegjës i prokurimit jo vetëm që nuk ka pezulluar zbatimin e aktivitetit të prokurimit, por me 06.06.2023 ka publikuar edhe Njoftimin për dhënie të kontratës. Në anën tjetër njoftimi mbi vendimin është publikuar me datë 11.05.2023 ndërsa ankesa është parashtruar me datë 24.05.2023. Me fjalë të tjera njoftimi për dhënie është publikuar gjatë kohës sa ankesa ka qenë duke u trajtuar nga Paneli Shqyrtues dhe atë vetëm 12/dymbëdhjetë ditë pas paraqitjes së ankesës në OSHP. Për këtë arsye Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të vendimit. Mirëpo në nenin 132 paragrafi 3, të LPP thuhet se, cituar: Gjatë vendosjes për shfuqizimin e një kontrate publike ose konkursi të projektimit, pjesërisht ose plotësisht, OSHP ose gjykata duhet të marrin parasysh dëmet në interesin publik që mund të rezultojnë nga ky veprim. Nëse OSHP ose gjykata konstaton se shfuqizimi do të kishte pasoja të rënda në interesin publik, atëherë OSHP ose gjykata nuk do të shfuqizojnë kontratën publike ose konkursin e projektimit, por do të përpiqen ta rregullojnë çështjen përmes nxjerrjes së një urdhri për kompensimin e dëmit sipas nën-paragrafëve 2.3 dhe/ose 2.4 paragrafi 2. të këtij neni"

- Përfundim -

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Paneli Shqyrtues do të inicioj sipas detyrës zyrtare, procedurën për marrjen e licencës së prokurimit publik ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë, për shkak të shkeljes së nenit 112 paragrafit 1 të LPP. Neni 112, në rastin konkret ka karakter kogent (detyrues) gjë që AK nuk ka të drejtë të shmanget nga aplikimi i këtyre dispozitave të cilat përbejnë parime bazë në legjislacionin e prokurimit publik.

Meqë kërkesë e ankuesit ka qenë edhe kompensimi i shpenzimeve procedurale, Kryetarja e panelit vendosi që të njëjtit ti ja aprovoj ato në vlerën e lejuar konform nenit 30, paragrafi 2, pika 2, të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë ditësh (60) nga dita e pranimit të këtij vendimi. Lidhur me pikën 1 dhe 2 të vendimit, është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP. Kurse, lidhur me pikën 1dhe 3 dhe 4 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën 5 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Spitali i Pergjithshem- Pejë**
- OE - **" ORTHO - IMPLANTS " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: